



Prishtinë, 14 dhjetor 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_872\_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 dhe Nenin 26 dhe Nenin 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe
- Aplikacionin e datës 21.06.2016 për vazhdim licence për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike (në vazhdim **“furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike”**) të bërë nga ndërmarrja “GENI-I Tirana Sh.P.K” adresa: Rr. Gustav Mayer 16, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

në seancën e mbajtur me datë 14 dhjetor 2016, nxori këtë:

## VENDIM

- I. **I VAZHDOHET** Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes “GENI-I Tirana Sh.p.k” –me numër licence ZRRE/Li\_34/12 për periudhën nga data **29 dhjetor 2016** deri **28 dhjetor 2021**.

## Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 21.06.2016 në formë elektronike ka pranuar Aplikacionin për vazhdim licence nga “GENI-I TIRANA” SH.P.K-DEGA NË KOSOVË.
  - ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të ZRRE-së dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për vazhdim licence.
  - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë me kapacitet **deri 400 MW**, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.




IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit "GEN-I TIRANA" SH.P.K-DEGA NË KOSOVË
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe
- Departamentit Ligjor dhe të Licencimit-ZRRE

**Bordi i ZRRE-së**

  
U.D Krenar Bujupi, kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar